



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
DHE SPORTIT

QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE  
DREJTORI I PËRGJITHSHËM

Nr. 9454 Prot.

Tiranë, më 06.12.2024

**NJOFTIM**

**PËR VEND PUNE**

**SEKRETAR I TITULLARIT**

**PRANË QENDRËS SË SHËRBIMEVE ARSIMORE**

Në mbështetje të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1013, datë 10.12.2010, "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve", i ndryshuar dhe të Urdhrit të Kryeministrit nr.146, datë 28.09.2018, "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Provimeve", i ndryshuar, Qendra e Shërbimeve Arsimore njofton shpalljen e vendit të lirë të punës:

- Në pozicionin e Sekretarit të Titullarit në QSHA. Ai/Ajo punon nën drejtimin e Drejtorit të Përgjithshëm të QSHA-së, si pjesë e ekipeve të punës brenda institucionit dhe bashkëpunon me pjesëtarët e tjerë të stafit. Sekretari punon nën drejtimin e Titullarit të QSHA-së dhe kryen të gjitha detyrat që i ngarkohen me rregulloren e brendshme të institucionit.
- Kualifikimet, aftësitë dhe eksperiencia që kërkohet për këtë vend pune janë:
  - ✓ Diplomë Bachelor/ Master
  - ✓ Të ketë njohuri mbi shkrimin akademik.
  - ✓ Të ketë aftësi të të dëgjuarit, të shkrimit dhe të folurit në mënyrë efikase.
  - ✓ Të ketë aftësi në përdorimin e programeve bazë kompjuterike.
  - ✓ Të ketë aftësi në përdorimin në mënyrë efikase të dhënave informatike.
  - ✓ Të ketë aftësi për të punuar në ekip dhe për të marrë iniciativa.
  - ✓ Të ketë aftësi për të punuar nën presion dhe me afate të ngushta kohore.
  - ✓ Të ketë aftësi të ndjekë dhe menaxhojë disa detyra në të njëjtën kohë.
  - ✓ Të tregojë përkushtim ndaj misionit dhe qëllimeve të Qendrës së Shërbimeve Arsimore.

Paga për pozicionin është në kategorinë VII.

3. Paraqitja e dokumenteve: Kandidati duhet të paraqesë brenda datës 10.01.2025 në sekretarinë e Qendrës së Shërbimeve Arsimore, me adresë: QSHA, Bulevardi Zhan D'Ark nr. 23, Tiranë, këto dokumente: Kërkesën për Aplikim, CV-në, fotokopje të noterizuar të diplomës dhe listës së notave, fotokopje të librezës së punës, fotokopje të certifikatave të kualifikimit, vërtetimin e gjendjes gjyqësore, raportin mjekësor për aftësinë në punë, një numër telefoni për t'u kontaktuar, si dhe adresën e plotë të vendqëndrimit.

Njoftimi për shpalljen e këtij vendi të lirë pune mund të gjendet edhe në faqen zyrtare të QSHA-së [www.qsha.gov.al](http://www.qsha.gov.al)

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

Aurora Balliu

